



KFW
Bank aus Verantwortung



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

State Secretariat for Economic Affairs SECO

HIDR DRINI

LARGIMI I UJERAVE TE NDOTRA NE JP TE KOSOVES

FAZA IV (PEJE)

(BMZ N°2014 70 467 / 2020 61 992)

Masat Shoqëruese



KONCEPTI për O&M të UJERAVE ATMOSFERIK

(Drafti)

Qershor 2019

Përgatitur nga
SaWa & AHT with Hidroing-DK

sachsenWasser
consulting + operations + management

AHT GROUP AG
Management & Engineering
Hidroing-DK
Ndërmarrja Projektuese dhe Konsulente
Consulting and Designing Company

Përmbajtja

1. Përmbldhje ekzekutive	Error! Bookmark not defined.
2. Hyrje	Error! Bookmark not defined.
3. Gjendja aktuale	Error! Bookmark not defined.
4. Mirëmbajtja e nevojshme e sistemit të ujërave atmosferik në Pejë	Error! Bookmark not defined.
5. Koncepti për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik në Pejë	Error! Bookmark not defined.
5.1 Ri-vendosje e sistemit të ndarë	15
5.2 Përgjegjësitë për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik	18
5.2.1. Vëmendje Institucionale	18
5.2.2. Baza kontraktuale	18
5.2.3. Cështje të koston	20

Lista e Figurave

Figura 3-1 Pamje e një kolektori të hapur në Pejë	8
Figura 3-2 Kolektor i hapur në qendër të Pejës	9
Figura 3-3 Shembuj të kushteve të pastërtisë së kolektorëve të hapur në Pejë	9
Figura 4-1 Ujëmbledhës në Pejë	12
Figura 4-2 Koka për pastrimin e gypave me profim të madh me diametër mbi 600 mm	14
Figura 5-1 Propozim për inspektim të rrjetit të kanalizimit me CCTV (burimi: SRS)	16
Figura 5-2 Cështje që duhet të merren parasysh për të përmirësuar kornizën ligjore	17

Lista e Tabelave

Tabela 4-1 Mirëmbajtja e nevojshme e rrjetit të ujërave atmosferik	10
Tabela 4-2 Aktivitetet e nevojshme mirëmbajtëse të rrjetit të ujërave atmosferik të Pejës	11
Tabela 4-3 Llogaritje e nevojës së fuqisë punëtore nga ana e Komunës së Pejës	12
Tabela 4-4 Llogaritje e nevojës për fuqi punëtore për Hidrodrini	13
Tabela 5-1 Masat për rivendosjen e sistemit të ndarë të kanalizimit	15
Tabela 5-2 Kosto operacionale KRU Hidrodrini (Pejë, 2018), burimi KRU Hidrodrini	20
Tabela 5-3 Llogaritje indikative e koston vjetore për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik	20

Lista e Anekseve

ANEKSI 1:	Marrëveshja për shërbime në mes KRUH dhe komunës së Pejës
ANEKSI 2:	Hartë e drenazhimit të ujërave atmosferik në Pejë
ANEKSI 3:	PSO për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik (s'i plotësim i PSO për O&M rrjetit të kanalizimit)
ANEKSI 4:	PSO për inspektim të lidhjeve shtëpiake
ANEKSI 5:	Transkript nga takimi i datës 10 maj 2019, me komunën e Gjakovës dhe KRU Hidrodrini

SHKURTESA

DN	Diametri nominal (përdorur edhe për dimensione në formë drejtkëndore)
DVGW	Shoqata Gjermane për Teknik e Shkencë, Gaz dhe Ujë
DWA	Shoqata Gjermane për Ujëra të Ndotura dhe Mbeturina
H&S	Shëndeti dhe siguria
ID	Identifikimi
LLC	Kompani me përgjegjësi të kufizuar
O&M	Operim dhe mirëmbajtje
PPE	Pajisje për mbrojtje personale
ppm	pjesë për mile
PM	Mirëmbajtje e planifikuar
RWC	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
PS	Stacion Pompimi
SCADA	Kontroll mbikëqyrjeje dhe përvetësim informacionesh
SOP	Procedura standarde të operimit
WSRA	Autoriteti Rregullativ për Shërbime të Ujit
WWTP	Impiant për trajtim të ujërave të ndotura

1. Përmbledhje Ekzekutive

Aktualisht, përgjegjësitë për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit të ndotur dhe atij atmosferik në Pejë janë të ndara. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është pronë e komunës së Pejës ndërsa titullar i rrjetit të kanalizimit të ndotur është Kompania e Ujësjellësit Rajonal Hidrodrini. Një Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të KRU Hidrodrini dhe Komunës së Pejës është nënshkruar me 26 prill 2010. Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi në mes Komunës dhe KRU-së në sektorin e ujërave dhe kanalizimit. Ky dokument është bazuar në origjinalin e Marrëveshjes për Shërbime përgatitur nga ARRU-ja.

Sistemi i kanalizimit atmosferik në qytetin e Pejës përbëhet nga një kombinim i kanaleve të hapura sipërfaqësore dhe disa gypave të ri të ujërave atmosferik. Këto të fundit kryesisht instalohen pas ndërtimit të rrugëve. Gjatësia e përgjithshme gypave të ujërave sipërfaqësor arrin rreth 47.3 km ndërsa gypat e kanalizimit atmosferik arrin gjatësinë në 14.3 km. Diametri i kanaleve të ujërave atmosferik varion nga DN 250 deri DN 1000.

Fillimisht, rrjeti ekzistues i kanalizimit të ndotur ishte projektuar s'i një sistem i ndarë. Megjithatë, për shkak të kyçjeve të parregullta, ky sistem pjesërisht funksionon s'i një sistem i kombinuar. *Strategjia e preferuar është ri-vendosje e një sistemi të ndarë, i cili do të ishte i dobishëm sa i përket O&M së ITUN-it të ri në Pejë.* Ka një përjashtim në pjesën lindore të Pejës, ku ekziston një sistem relativisht i ri i kombinuar i lidhur me kanalizimin e pjesës perëndimore (i ndërtuar gjatë viteve 2008-2009) dhe s'i duket funksion siç duhet.

Gjendja ekzistuese e bënë të vështirë operimin e sistemit të kanalizimit ashtu siç duhet. Përpos nevojës për ndarje të sistemit sanitar nga ai atmosferik, *p.sh shndërrimi i kyçjeve të gabuara në sistem të ujërave atmosferik kërkon edhe mirëmbajtje të përshtatshme. Qëllimi i këtij koncepti është përcaktimi i aktiviteteve dhe burimeve të nevojshme për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujërave atmosferik në qytetin e Pejës dhe për të siguruar bazamentin e një marrëveshje kontraktuale në mes të KRUH-së dhe komunës së Pejës, për ekzekutimin e shërbime përkatëse të O&M-së. Ky dokument po ashtu adreson çështjen e ndarjes së kanalizimit sanitar nga ai atmosferik tek burimi (kyqjet shtëpiake) në Pejë.*

KRU Hidrodrini do ishte në gjendje të operonte në mënyrë më ekonomike me sistemin e ujërave atmosferik në Pejë se sa vet komuna e Pejës. Aktivitetet për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujërave atmosferike janë pothuajse identike me kanalizimin sanitar.

Ri-vendosje e sistemit të ndarë të ujërave atmosferik dhe atyre të ndotura

Janë identifikuar masat e përgjithshme vijuese:

- *Inspektimin e kyçjeve shtëpiake të kanalizimit për të përcaktuar nivelin e kyçjeve të parregullta :* Është përgatitur një dokument me procedura standarde të operimit për inspektimin e kyçjeve shtëpiake në rrjetin e kanalizimit. Pjesë të këtij aktiviteti po ashtu mund të përfshihen edhe masat e pjesës së Fazës V (dhe VI), pasi që ka shumë gjasa përfshirja e 22 km rrjet për inspektim me kamera me qark të mbyllur CCTV si dhe teste me tym për gjetjen e kyçjeve të parregullta.

Apelimi pronarëve të shtëpive që t'i rregullojnë kyçjet e parregullta (Fushatë e MP-së)

- *Ndarjen e sistemeve*
- *Përmirësimi i bazës ligjore për ndarje të sistemeve, p.sh përmes një udhëzimi komunal ose rregullore kombëtare.*

Rregullore shtesë të nivelit qendror, nivelit të ARRU's ose atij komunal mund të jenë të nevojshme me qëllim të institucionalizimit më të mirë të ndarjes së sistemeve. Në këtë dokument janë elaboruar çështjet që duhet të merren parasysh.

Përgjegjësitë për O&M të sistemit të ujërave atmosferik

Në mungesë të një rregulloreje të nivelit vendor në lidhje me menaxhimin e ujërave atmosferik dhe financimin e aktiviteteve të ndërlidhura me operim dhe mirëmbajtje, rekomandohet nënshkrimi i një marrëveshjeje në mes KRU Hidrodrini dhe komunës së Pejës përmes së cilës përgjegjësitë për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujërave atmosferik t'i kalojnë KRU Hidrodrinit. Pasi që Marrëveshja aktuale e Shërbimeve nuk përmban një dispozitë të tillë (por është bazuar në një standard vendor të përshkruar nga ARRU), atëherë propozohet arritje e një marrëveshjeje të veçantë në mes KRU Hidrodrini dhe komunës së Pejës.

Çështje relevante për një marrëveshje kontraktuale të këtij lloji janë prezantuar në koncept, ndërsa një përlogaritje indikative në lidhje me koston vjetore për sipërmarrjen e këtyre aktiviteteve në emër të komunës së Pejës është përfshi në pjesën e fundit të konceptit.

2. Hyrje

S'i pjesë e programit "Largimi i ujërave të ndotura nga Kosova jugperëndimore faza IV, Pejë" (Projekti), financuar përmes bashkëpunimit financiar mes Gjermanisë, Zvicrës në njërin anë dhe Kosovës në anën tjetër (BMZ ID 2014 70 467/ 2020 61 992) përmes KfW-së bankës për zhvillim dhe sekretariat Zviceran për çështje ekonomike (SECO), me dt. 14.12.2017 është nënshkruar kontrata për shërbime konsulente në mes të KRU Hidrodrini dhe asociacionit Sachsen Wasser/ AHT/ Hidroing për pjesën e masave shoqëruese të projektit. Këto masa shoqëruese (MSH) kanë për synim ndërtimin e kapacitete në KRU Hidrodrini.

Aktualisht, përgjegjësitë për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit të ndotur dhe atij atmosferik në Pejë janë të ndara. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është pronë e komunës së Pejës ndërsa titullar i rrjetit të kanalizimit të ndotur është Kompania e Ujësjetës Rajonal Hidrodrini. Një **Marrëveshje Bashkëpunimi** në mes të KRU Hidrodrini dhe Komunës së Pejës është nënshkruar me 26 prill 2010. (shih po ashtu **Aneksin 1**). Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi në mes Komunës dhe KRU-së në sektorin e ujërave dhe kanalizimit. Ky dokument është bazuar në origjinalin e Marrëveshjes për Shërbime përgatitur nga ARRU-ja.

Parimisht, për qytetin e Pejës ekzistojnë dy mundësi s'a i përket largimit të ujërave atmosferik të cilat duhet të merren parasysh dhe përfshihen në strategjitë për largimin e ujërave atmosferik:

- *Lidhja e ujërave atmosferik me tubacionin ekzistues të ujërave atmosferik në qendër të qytetit dhe nëpër zona me densitet të lartë.*
- *Depërtimi i ujërave atmosferik në sipërfaqe të tokës ose rrugëve të pashtuara.*

Sistemi i kanalizimit atmosferik në qytetin e Pejës përbëhet nga një kombinim i kanaleve të hapura sipërfaqësore dhe disa gypa të ri të ujërave atmosferik. Këto të fundit kryesisht instalohen pas ndërtimit të rrugëve. Gjatësia e përgjithshme gypave të ujërave sipërfaqësor arrin rreth 47.3 km ndërsa gypat e kanalizimit atmosferik arrin gjatësinë në 14.3 km. Diametri i kanaleve të ujërave atmosferik varion nga DN 250 deri DN 1000. (shifrat janë bazuar në raportin e Dahlem-it)

Plani i tubacioneve të reja të ujërave atmosferik është paraqitur në **Aneksin 2**. Kanalet e hapura nuk janë të shenjëzuara në planimetrin dhe nuk janë të matura

Fillimisht, rrjeti ekzistues i kanalizimit të ndotur ishte projektuar s'i një sistem i ndarë. Megjithatë, për shkak të kyçjeve të parregullta, ky sistem pjesërisht funksionon s'i një sistem i kombinuar. Një gjë e tillë nënkupton që ujëra atmosferik mund të depërtojnë në sistemin e kanalizimit të ndotur edhe pse është bërë e qartë që ujërat atmosferik përcillen në sistemin e kullimit të rrugëve dhe ujërat e ndotura nuk arrijnë të përzihen me to.

Zhvillimet e mëtejme kërkojnë menaxhim të përbashkët të sistemit të kanalizimit të ndotur dhe atij atmosferik. *Strategjia e preferuar është rivendosja e një sistemi të ndarë i cili do të ishte më i dobishëm sa i përket operimit dhe mirëmbajtjes së ITUN-it të Pejës.* Nuk ka ndonjë përjashtim në pjesën përfundimtare të Pejës ku ka një sistem relativisht të ri të kombinuar i lidhur me tubacionin e pjesës lindore (ndërtuar në vitet 2008-2009) i cili duket që funksionon mirë. Është thënë që ky

tubacionin pritet të mirëbahet, mirëpo stabilimentet shkapërderdhëse të ujërave atmosferik do të vendosen në skaje të tubacioneve dhe një gjë e tillë do të reduktonte sasinë e rrjedhës së ujit për në ITUN gjatë kohërave me të reshura të mëdha.

Gjendja ekzistuese e bënë të vështirë operimin siç duhet me sistemin e ujërave atmosferik. Përpos nevojës për ndarje të sistemeve, p.sh duke i rregulluar kyçjet e parregullta, duhet edhe një mirëmbajtje e duhur e sistemin e ujërave atmosferik.

Ndërsa plani për mirëmbajtje preventive të kanalizimit sanitar të Pejës tashmë është elaboruar (përfshi procedurat e rëndomta standarde të operimit), qëllimi i këtij koncepti është definimi i aktiviteteve dhe burimeve të nevojshme për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të ujërave atmosferik në qytetin e Pejës dhe ofrimi i një baze për një marrëveshje kontraktuale në mes komunës së Pejës dhe KRU Hidrodrini s'a i përket ofrimit të shërbimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit në fjalë. Një gjë e tillë adreson edhe çështjen e ndarjes së rrjeteve të kanalizimit të ndotur nga ai atmosferik tek burimi, respektivisht tek kyçjet shtëpiake.

3. Gjendja ekzistuese

Kullimi i rrugëve të qytetit është përgjegjësi e komunës së Pejës. Aktualisht vetëm kullimi i rrugëve është i lidhur me kolektorët e ujërave atmosferik. Uji nga të reshurat rrjedh nëpër sipërfaqe të rrugëve ose ujëmbledhës dhe derdhet në kolektor të ujërave atmosferik. Rrjeti i ujërave atmosferik ka kapacitet të mjaftueshëm.

KRU Hidrodrini është përgjegjëse për kullimin/ drenazhimin e pronave të qytetarëve. Nëpër prona të qytetarëve mbliidhen ujërat e ndotura por edhe ato atmosferik. S'a i përket kullimit të ujërave atmosferik nga prona të qytetarëve, aktualisht ekzistojnë opsionet e mëposhtme:

1. *Ujërat atmosferike nuk janë të lidhura në sistem dhe rrjedhin rrugëve the trotuareve të qytetit:*
2. *Ujërat atmosferik rrjedhin përmes kyçeve shtëpiake dhe derdhen në kolektorët e ujërave të ndotura .*

Kjo situatë nuk është e kënaqshme. Në njërin anë, sipërfaqet e rrugëve janë të dëmtuara s'i pasojë e ujërave atmosferik që rrjedhin nga shtëpitë, ndërsa në anën tjetër është në interes të kompanisë që të ketë sa më pak ujë të shiut në kanalet e qytetit. Një situatë e tillë komplikon operimin e stacioneve të planifikuara të pompimit dhe të ITUN-it. Rritja e sasisë së ujërave të ndotura qon edhe në shtimin e kostos së energjisë.

Sistemi i ujërave atmosferik në Pejë përbëhet nga kolektorë të sipërfaqeve të hapura, tubacioneve dhe pusetave, të cilat janë në përputhje me rregullat e përgjithshme të ndërtimit. Sistemi funksionon me gravitet. Kolektorët e ujërave atmosferik zakonisht vendosen gjatë fazës së ndërtimit të rrugëve.

Siç është cekur në pjesë hyrëse të këtij dokumenti, gjatësia e përlllogaritur e kanaleve të hapura është diku në 50 km, ndërsa gjatësia e gypave drenazhues të ujërave atmosferik është diku nën 15 km. (shih po ashtu **ANEKSIN 1**). Diametri i kolektorëve të ujërave atmosferik sillet nga DN 250 deri DN 1000.



Është bërë e ditur që njësia e GIS e KRUH-së grumbullon të dhëna mbi rrjetin e kanalizimit paralelisht me të dhëna mbi sistemin e ujërave atmosferike.

Figura 3-1 Pamje e një kolektori të hapur në Pejë

Rrjeti i ujërave atmosferik përgjithësisht është në gjendje të mirë strukturore. Fatkeqësisht nuk ka qasje publike në disa nga kanalet e hapura dhe kjo e bën të vështirë mirëmbajtjen e tij.

Kushtet e pastrimit nuk janë aq të mira. Zhavor, gurë, dhe depozita të ujërave të ndotura hasen nëpër kolektor. Disa nga kolektorët e hapur rrezikohen nga rritja e barishteve për shkak të mungesës së mirëmbajtjes.



Figura 3-2 Kolektor i hapur në qendër të Pejës

Fotografia vijuese ilustron faktin që mirëmbajtja, posaçërisht pastrimi preventiv duhet të përmirësohet.



Figura 3-3 Shembuj të gjendjes së pastërtisë së kolektorëve të hapur në Pejë

Domosdoshmëritë për mirëmbajtje të sistemit të ujërave atmosferik të Pejës

Tabela vijuese paraqet aktivitetet e domosdoshme për mirëmbajtje të rrjetit të ujërave atmosferik të Pejës:

Inspektimi	Servisimi	Riparimi
Inspektimi i kolektorëve të hapur	Pastrimin e kolektorëve të hapur	Riparimin e kolektorëve të hapur
Inspektimi i pusetave	Pastrimin e gypave të kanalizimit	Riparimin e gypave
Inspektimi i gypave derdhës	Pastrimin e pusetave	Riparimin e pusetave
Inspektimi i ujëmbledhësve	Pastrimin e ujëmbledhësve	Riparimin e ujëmbledhësve

Tabela 4-1 Mirëmbajtja e nevojshme e rrjetit të ujërave atmosferik

Inspektimi

Inspektimi është një aktivitet i vazhdueshëm kontrolli dhe monitorimi. Inspektimi dhe kontrolli i infrastrukturës së ujërave atmosferik bëhet vizualisht. Inspektimi i paraprinë aktiviteteteve tjera mirëmbajtëse.

Servisimi

Servisim (pastrim) do të thotë të gjitha masat me qëllim të ruajtjes së performancës maksimale të sistemit të kullimit të ujërave atmosferik. Fundërrinat ose bllokimet e kanalizimit pengojnë performancën e tij.

Tabela vijuese ilustron aktivitetet mirëmbajtëse së bashku me shifrat e nevojshme për llogaritjen e kohës së punës.

Pozicioni	Emri	Intervali gjatë vitit	Koha për njësi	Numri i stafit
1	Inspektimi i kolektorëve të hapur	1	2.0....4.0 h në km	2
2	Inspektimi i pusetave	0.1....0.5	0.5....1.5 h në cop	2
3	Inspektimi i derdhësve	1....4	0.5....1.5 h në cop	2
4	Inspektimi ujëmbledhësve	2	0.2....0.4 h në cop	1....2
5	Pastrimi menakin i kolektorëve të hapur	0.2....0.5	80....120 h në km	3....4
6	Pastrimi i kolektorëve të haur me autocisternë	0.2....0.5	40....60 h në km	3....4
7	pastrimi i gypave të kanalizimit me autocisternë	0.2....0.5	20....30 h në km	2....3
8	Pastrimi i pusetave	0.2....0.5	0.5....1.0 h në	2....3

Pozicioni	Emri	Intervali gjatë vitit	Koha për njësi	Numri i stafit
			cop	
9	Pastrimi i ujëmbledhësve	2	0.2.....0.6 h në cop	2
10	Riparime	Sipas nevojës		2....3

Tabela 4-2 Aktivitetet e nevojshme mirëmbajtëse të rrjetit të ujërave atmosferik të Pejës




Figura 4-1 Ujëmbledhës në Pejë

Në dy tabelat vijuese janë bërë krahasime s'a i përket nevojës për personel për të cilët do të ketë nevojë komuna e Pejës ose KRUH-ja, pa marrë parasysh se kush do të merrte përgjegjësinë për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujërave atmosferik. Ky krahasim ka marrë parasysh edhe infrastrukturën dhe pajisjet ekzistuese të KRU Hidrodrini.

Nr.	Pozicioni	Numri i stafit	Koha për njësi	Numri	Intervali gjatë vitit	Orë pune në vit
1	Inspektimi i kolektorëve të hapur	2	2,0.....4,0 h/km	50 km	1	300
2	Inspektimi i pusetave	2	0,5.....1,5 h/cop	500 cop	0.3	300
3	Inspektimit i derdhësve	2	0,5.....1,5 h/cop	5 cop	4	40
4	Inspektimi i ujëmbledhësve	1...2	0.2.....0.4 h/cop	1000 cop	2	900
5	Pastrimi manual i kolektorëve të hapur	3...4	80.....120 h/km	50 km	0.2....0.5	6,125
6	Pastrimi i pusetave	2...3	0.5....1.0 h/cop	500 cop	0.2.....0.5	328
7	Pastrimi i ujëmbledhësve	2	0.2.....0.6 h/cop	500 cop	2	800
8	Të ndryshme					500
	Totali	5				9,293

Tabela 4-3 Përlllogaritje e fuqisë së nevojshme punëtore për komunën e Pejës

Nr.	Pozicioni	Numri i stafit	Koha për njësi	Numri	Intervali gjatë vitit	Orë pune në vit
1	Inspektimi i kolektorëve të hapur	2	2,0.....4,0 h/km	50 km	1	300
2	Inspektimi i pusetave	2	0,5.....1,5 h/cop	500 cop	0.3	300
3	Inspektimit i derdhësve	2	0,5.....1,5 h/cop	5 cop	4	40
4	Inspektimi i ujëmbledhësve	1...2	0.2.....0.4 h/cop	1000 cop	2	900
5	Pastrimi manual i kolektorëve të hapur	3...4	40.....60 h/km	50 km	0.2....0.5	3,063
6	Pastrimi i pusetave	2...3	0.5....1.0 h/cop	500 cop	0.2.....0.5	328
7	Pastrimi i ujëmbledhësve	2	0.2.....0.6 h/cop	500 cop	2	800
8	Të ndryshme					500
	Total	3				6,231

Tabela 4-4 Përlogaritje e fuqisë së nevojshme punëtore për Hidrodrinin

Tabela e sipërme sugjeron që Hidrodrini mund të operoj me rrjetin e ujërave atmosferik të Pejës në mënyrë më ekonomike se s'a komuna e Pejës. Marrja përsipër e operimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujërave atmosferik nga ana e KRU Hidrodrinit do t' rezultonte me përfitime vijuese:

- **Hidrodrini posedon më shumë kapacitete të operimit dhe mirëmbajtjes (GIS, autocisternën e tipit të kombinuar)**
- **Hidrodrini ka staf më të kualifikuar për këtë qëllim**
- **Hidrodrini posedon listën e konsumatorëve (regjistrin)**
- **Garantohet operim më ekonomik i ITUN-it dhe stacioneve të reja të pompimit të ujërave të ndotura.**
- **Kostoja për operim dhe mirëmbajtje të sistemit të kullimit të ujërave atmosferik i shpërndahet komunës dhe pronarëve të objekteve.**

Veprimet për O&M të sistemit të ujërave atmosferik janë po aq të rëndësishme s'a edhe për atë të ujërave të ndotura. Këto veprime janë përshkruar në raportin "Plani për mirëmbajtje preventive të kanalizimit të Pejës" të muajit maj 2019, respektivisht në dokumentin e bashkangjitur të titulluar "Procedurat Standarde të Operimit" (PSO).

Për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik kërkohen aktivitetet vijuese mirëmbajtëse:

- **Inspektimi i kanaleve të hapura përmes futjes në to**
- **Pastrimin e kanaleve të hapura sipas nevojës, mekanikisht ose përmes autocisternës**
- **Pastrimin e tubacioneve të ujërave atmosferik sipas nevojës**
- **Inspektimin e pusetave dhe derdhësve**
- **Pastrimin e pusetave dhe derdhësve sipas nevojës**

- *Inspektimin e ujëmbledhësve sipas intervalit dy herë gjatë vitit*
- *Pastrimin e ujëmbledhësve sipas nevojës, mekanikisht ose me autocisternë*

Informata shtesë në lidhje me këtë detyrë janë dhënë në **ANEKSIN 3**.

Pajisjet

Përgjithësisht, Hidrodrini posedon makinerinë e nevojshme- autocisternën dhe kamionçinën për të kryer punë mirëmbajtëse të sistemit të ujërave atmosferik, meqë edhe veprimet s'a i përket mirëmbajtës së ujërave të ndotura nuk dallojnë shumë. Megjithatë, do të ishte e domosdoshme blerja e kokave të reja (hundëzave) për pastrim të gypave të profilit të madh.



Figura 4-2Kokat për pastrimin e gypave me profil të madh dhe ato me diametër mbi 600 mm

Çmimi i një koke të tillë përafërsisht sillet rreth € 8,000.

Sa i përket rivendosjes/ ndërtimit të kyçjeve shtëpiake të ujërave atmosferik, p.sh rregullimin e kyçjeve të parregullta në sistem, propozohet që kompanitë ndërtimore të obligohen përmes kontratës të kryejnë këtë punë dhe të paguhen për një gjë të tillë. Për arsye ekonomike Hidrodrini nuk duhet të ngre kapacitete për një gjë të tillë.

4. Koncepti për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik në Pejë

5.1 Ri-vendosje e sistemeve të ndara

Siç është cekur më lartë, **strategjia e preferuar mbetet ri-vendosje e një sistemi të ndarë i cili do të kishte dobi në O&M të impiantit të ri të ITUN-it në Pejë**. Siç është deklaruar, nuk ka ndonjë përjashtim për pjesën lindore të Pejës ku tashmë ekziston një sistem relativisht i ri i kombinuar, i lidhur me tubacionin lindor (ndërtuar në vitet 2008-2009) e cili duhet se funksionon mirë. Është lënë të kuptuar se gypi do të mirëmbahet dhe se në skaje të sistemit do të vendosen pajisje për shkapërderdhje të ujërave atmosferik me qëllim reduktimin e sasisë së ujit për në ITUN gjatë te reshurave të mëdha atmosferike.

Është parë e domosdoshme ndërmarrja e masave të mëposhtme:

N°	Masa / Aktiviteti	Përgjegjës	Afati kohor (kohëzgjatja)
1	Inspektimi i lidhjeve shtëpiake në kanalizim për të përcaktuar nivelin e parregullsisë	<ul style="list-style-type: none"> KRU Hidrodrini Konsulenti i fazës V 	2019 / 2020 (ca. 12 muaj)
2	Apel pronarëve të objekteve që t'i rregullojnë lidhjet e parregullta (Fushatë sensibilizimi, MP)	<ul style="list-style-type: none"> KRU Hidrodrini Komuna e Pejës Mbështetur nga konsulenti i MSH 	2020 / 2021 (ca. 2 -3 muaj)
3	Rregullimi i lidhjeve në siste,	<ul style="list-style-type: none"> Pronarët e objekteve / Konsumatorët 	2020 / 2021 (ca. 24 muaj)
4	Përmirësimi i bazës ligjore në lidhje me ndarjen e sistemeve, p.sh rregullore komunale ose në nivelin qendror	<ul style="list-style-type: none"> Komuna e Pejës ARRU Autoriteti kombëtar legjislativ (ligji për ndërtim) 	2021/ 2022 (ca. 24 muaj)

Tabela 5-1 Masat e nevojshme për rivendosje të sistemit të ndarë të kanalizimit

S'a i përket masës së parë të identifikuar; inspektimin e lidhjeve shtëpiake në kanalizim për të përcaktuar nivelin e parregullsisë, konsulenti ka elaboruar dhe bashkangjitur në këtë koncept, një procedurë/qasje rutinore s'i **ANEKS 4: PSO Inspektim i lidhjeve shtëpiake në kanalizim**.

Disa nga aktivitetet inspektuese mund të përfshihen në vazhdimin e Programit për Largimin e Ujërave të Ndotura nga Kosova Jugperëndimore, Faza V (dhe VI). Sipas raportit inspektues të konsulentit të fazës V, propozohet inspektimi i gypave me TV me qark të mbyllur CCTV, për të parë dëmtimet e mundshme dhe klasifikimin e tyre në gjatësi prej **22 km të gypave të kanalizimit** në Pejë (diametri DN 200 to DN 700) shih po ashtu Figurën vijuese 5-1.

Për shkak të problemeve me kyçje të parregullta në kanalizim(të ndotur dhe atmosferik), është planifikuar tenderimi i inspektimit të gypave me anë të TV-së me qark të mbyllur (CCTV),përfshi edhe **Testimi përmes tymit** për të detektuar kyçjet e parregullta. Një element tjetër i inspektimit do të jetë edhe **Incizimi i pusetave** , për shkak se në shumë vende në Pejë, pusetat nuk vërehen dot nga sipërfaqja e rrugës, e një gjë e tillë e bënë më të vështir procesin e O&M dhe të pastrimit të kanaleve. Incizimi i pusetave të padukshme përmes gjeo-radarit do të përfshi një gjatësi prej rreth 51km. Koha e nevojshme për këtë aktivitet inspektimi është vlerësuar të jetë së paku 7 muaj dhe sipas planifikime të përgjithshme do të nisët diku ka fundi i vitit 2019/ deri në fillim ose verë të vitit 2020.

Rezultati nga inspektimi përmes CCTV-ve dhe incizimi i pusetave duhet të integrohen në sistemin e GIS (Arclinfo) të kompanisë. Deri tani, vetëm 23% e rrjetit të kanalizimit është incizuar në GIS; ndërsa s'a i përket lidhjeve shtëpiake, ka pak informata në GIS.




Figura 5-1 Rrjeti i kanalizimit të Pejës i propozuar për t'u inspektuar me CCTV (burimi: SRP)

S'a i përket përmirësimit (vendosjes) së një bazë ligjore për të garantuar ndarje të sistemit sanitar nga ai i ujërave atmosferik në të ardhmen, do të bëhet vlerësimi i parakushteve ligjore ekzistuese, nëse ato janë të mjaftueshme, ose nëse do të ketë nevojë për rregullore shtesë (të nivelit vendor/ARRU të cilat do të fuqizonin KRU't përmes autoritetit implementues, ose në nivelin lokal, në formë të rregullores).

Në Gjermani, ekziston një standard i përgjithshëm vendor i specifikuar nga ana e cilës komunë individualisht (ose asociacioni ndër-komunal) i njohur s'i **Kushtet e Përgjithshme për largimin e ujërave të ndotura** *Allgemeine Entsorgungsbedingungen Abwasser, AEB*). Këto kushte definojnë dhe përcaktojnë përgjegjësitë për kompanitë e shërbimeve publike ose marrësin (konsumatorin) e shërbimeve publike. Duke pasur parasysh një kornizë të tillë, atëherë edhe në Pejë, duhet merren në konsiderat çështjet vijuese në :

Parakushtet elementare

- KRU Hidrodrini është përgjegjës për O&M të sistemit të kanalizimit.
- Sistemi i kanalizimit përbëhet nga kolektorë, tubacione, stacione pompimi dhe impiante për trajtim të ujërave të ndotura. Hidrodrini përcakton llojin dhe fushëveprimin e pajisjeve të përdorura për kanalizim
- Sistemi i kanalizimit po ashtu përfshin edhe lidhjet shtëpiake në ato raste kur ato gjenden nëpër prona dhe rrugë publike.

E drejta për lidhje dhe shfrytëzim

Secili konsumator mund të kërkojë që prona e tij e cila ka qasje në kolektor, të kyçet në sistemin e kanalizimit publik. Ai ka të drejtë që të shkarkojë ujërat e ndotura në sistemin e kanalizimit publik. Konsumatori nuk mund të kërkojë ndërtimin e kolektorëve të ri, as ndërrimin e atyre ekzistues.

Detyrimet e lidhjes dhe shfrytëzimit

Konsumatorët që kanë mundësi të kyçen në sistem të kanalizimit, janë të obliguar që të lidhin në kanalizimin publik, pronat ku ka ndërtime, por edhe ato në të cilat nuk ka ndërtime (lidhje të detyruara). Një kyçje e tillë (e detyruara) nuk mund të bëhet në rast se lidhja shtëpiake nuk mund të realizohet për shkak të rrethanave ose çështjeve ligjore. Një pronë e "ndërtuar" konsiderohet ajo pronë në të cilën ekziston strukturë qoftë e përhershme ose e përkohshme por e cila do të ketë nevojë për sistem kanalizimi.

Lidhjet shtëpiake

Lidhja shtëpiake është një lidhje në mes kanalizimit publik dhe kullimit/drenazhimit të pronës private. Lidhjet shtëpiake bëhen, rinovohen, ndryshohen dhe mirëmbahen nga ana e Hidrodrinit. Hidrodrini mund t'i urdhëroj pronarët e objekteve që të bëjnë plotësisht ose pjesërisht, vendosjen, renovimin, ndërrimin dhe mirëmbajtjen e kyçjeve nëpër pronat e tyre. Është Hidrodrini ai që përcakton numrin, llojin, madhësinë e lidhjes dhe menaxhimin e lidhjeve shtëpiake. Ata gjithashtu vendosin se në cilin kanal mund të bëhet lidhja.

Sistemi i kullimit të objekteve(pronave)

- **Kullimi i pronave- objekteve, përgjithësisht duhet të bëhet përmes sistemit të ndarë e që nënkupton; vendosjen e një gypi sanitar dhe një gypi tjetër atmosferik të cilët nuk duhet të jenë të lidhur me njëri tjetrin.**
- **Secila pronë e lidhur me kanalizimin publik, fillimisht duhet të ketë të ndërtuar një sistem të kullimit, i cili operohet, mirëmbahet dhe ndryshohet sipas praktikave të pranueshme ndërtimore.**
- Çdo individ që ka kyçje shtëpiake duhet mbrojt veten nga kthimi i ujit të kanalizimit mbrapa nga rrjeti i kanalizimit.

Dokumentacioni i nevojshëm për aprovimin e lidhjes

- a) Harta e pronës/ngastrës
- b) Diagrami i profilit të gypit
- c) Puseta afër objektit ekzistues ose ati të ri
- d) Për konsumatorë komercial ose industrial, informata mbi llojin e ujit që pritet të shkarkohet dhe në lidhje me paratrajtimin.
- e) Hidrodrini është i autorizuar të bëjë inspektimin e sistemit të kullimit në çdo kohë me qëllim të mostërzimit dhe matjeve tjera.

Figura 5-2 çështjet që duhet merren parasysh me qëllim të përmirësimit të kornizës ligjore

5.2 Përgjegjësitë për O&M të rrjetit të kanalizimit atmosferik

5.2.1. Vëmendja institucionale

Gjatë fazës së përgatitjes së konceptit për O&M të sistemit të ujërave atmosferik, është mbajtur një takim me ARRU-në në Prishtinë, gjatë së cilit është kuptuar se autoriteti ka për qëllim rregullimin e çështjes së menaxhimit të ujërave atmosferik, duke përfshi edhe koston e shkaktuar për O&M të ujërave atmosferik në nivelin vendor. Një gjë e tillë do të nënkuptonte edhe përditësimin e Marrëveshjes për Shërbime në mes të KRU-ve dhe Komunave përkatëse. Duhet të ceket, që një gjë e tillë nuk pritët të ndodhë shpejtë, duke marrë parasysh një mori çështjesh tjera me të cilat po merret ARRU.

Në rast se fillohet me implementim të rregulloreve të nivelit vendor dhe të një sistemi të ri tarifor, atëherë pritët që KRU-të do të marrin përgjegjësinë e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit atmosferik, së bashku me fondet e nevojshme, që do të rrjedhin nga tarifat prej konsumatorit për të bërë një gjë të tillë. Tarifat për shkarkim të ujërave atmosferik, aty ku aplikohen, kryesisht llogariten në bazë të hapësirës së shtruar (sipërfaqja e kulmit dhe sipërfaqet e shtruara në tokë) të cilat kontribuojnë në shkarkimin e ujërave atmosferik në sistem (p.sh tarifat sipas metrit në katror m², në disa raste të përpjesëtuar edhe me faktor tjerë, varësisht prej llojit dhe përkrahimit të sipërfaqes së shtruar).

Duke marrë parasysh faktin që O&M i rrjetit të ujërave atmosferik është një çështje mjaft e rëndësishme dhe që aktualisht në qytetin e Pejës nuk po bëhet ashtu siç duhet, atëherë s'i mundësi mbetet edhe arritja një marrëveshje tjetër në mes komunës së Pejës dhe KRU Hidrodrini në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave atmosferik, së paku deri sa të futet në aplikim ndonjë rregullore e përgjithshme e nivelin qendror. Gjatë fazës së përgatitjes së këtij koncepti, është mbajtur një takim me KRU Hidrodrini dhe Komunën e Pejës, gjatë së cilit në parim të dy palët janë pajtuar që do të ishte e dobishme që operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave atmosferik t'i kalonte KRU Hidrodrini me qëllim të funksionimit efikas. (shih **ANEKSIN 5**). Në këtë rast, KRU Hidrodrini do t'i nevojiteshin fonde me qëllim të ofrimit të shërbimeve të O&M të rrjetit atmosferik në emër të komunës së Pejës, s'i një përgjegjësi shtesë. Pjesa vijuese përmban informata shtesë konceptuale në lidhje me këtë çështje,

5.2.2. Baza kontraktuale

Marrëveshja në mes komunës së Pejës dhe KRU Hidrodrini në lidhje me shërbimet për ujëra të ndotura dhe ato atmosferike është nënshkruar me 26 prill 2010 (Marrëveshje për Shërbime, shih **ANEKSI 1**). Kjo marrëveshje është bazuar në dokumentin standard të ARRU-së. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi në mes KRU Hidrodrini dhe komunës së Pejës në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Nuk ekzistojnë ndonjë dispozitë të qartë s'a i përket O&M së rrjetit të ujërave atmosferik dhe se ajo çfarë bie në sy është që operimi dhe mirëmbajtja e këtij rrjeti nga ana e Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal, parimisht nuk vërehet në këtë dokument.

Strategjia më e preferuar dhe më efikase mbetet ri-vendosja e sistemit të ndarë të kanalizim sanitar dhe atij atmosferik në Pejë. Një ndarje e tillë do të garantonte operim me kosto efektive të sistemit të ujërave atmosferik në Pejë. Kjo do të nënkuptonte që ujërat atmosferik nga objektet/pronat e qytetarëve do të derdheshin direkt në rrjetin e ujërave atmosferik.

Pasi që Marrëveshja për Shërbime, siç u tha më lartë, është bazuar në standard të nivelit vendor (duke ndjekur udhëzimet rregullative të ARRU-së), atëherë propozohet që përgjegjësitë për O&M të ujërave atmosferik t'i kontraktohen dhe kalojnë KRU Hidrodrini përmes një marrëveshje të veçantë në mes Komunës dhe KRU-së.

Disa çështje të cilat do të mund të rregulloheshin përmes një marrëveshje të tillë kontraktuale do të përfshinin:

- **KRUH është përgjegjëse për O&M të kullimit të sistemit publik të ujërave atmosferik. Këtu përfshihen kolektorët e hapur, gypat, pusetat dhe strukturat e ndryshme.**
- **KRUH ka të drejtë të bëjë lidhjet e gypave të ujërave atmosferik nga prona e qytetarëve deri tek kolektorit i publik i ujërave atmosferik kur një gjë e tillë është teknikisht e mundur, duke u paguar për një shërbim të tillë.**
- **KRUH garanton që ujëmbledhësit e ri mund të lidhen në rrjetin e ujërave atmosferik**
- **KRUH ka të drejtë kompensimi vjetor nga ana e komunës së Pejës për aktivitetet e saj të rregullta të operimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujërave atmosferik. Kompensimi do të verifikohet/rishikohet çdo një apo dy vite, varësisht nga zhvillimet/ shtimi i gjatësisë dhe strukturës së rrjetit të ujërave atmosferik¹. Kompensimi duhet të mbuloj koston e KRUH-së dhe mund të paguhet në formë paushalli ose në bazë të njësisë për km të kolektorëve/gypave dhe sipas njësisë së strukturës së mirëmbajtur**
- **Komuna e Pejës është përgjegjëse për investime në zgjerimin dhe renovimin e rrjetit.**
- **Çështja e pronësisë mbi rrjetin e kanalizimit atmosferik mbetet e paprekur, komuna e Pejës mbetet zotëruar i aseteve të rrjetit të ujërave atmosferik.**

¹Kjo do të konsiderohet s'i zgjidhje e ndërmjetme derisa të caktohet një tarifë e nivelit vendor.

5.2.3. çështje të lidhura me koston

Tabela vijuese jep një pasqyrë në lidhje me koston operacionale në KRU Hidrodrini në vitin 2018, e ndarë për ujësjellës dhe kanalizim pa zhvleftësim (të dhënat janë marrë nga KRU Hidrodrini):

Kosto operacionale 2018 (për Pejë)				
N°	artikulli i koston	KOSTO		
		UJE	KANALIZIM	
1	Pagat bruto	730.097,73	81.121,97	74,01%
2	Mirëmbajtje dhe Riparime	61.048,99	6.783,22	6,19%
3	Rryma elektrike	142.773,30	15.863,70	14,47%
4	Shpenzimet e Derivateve	23.820,32	2.646,70	2,41%
5	Kemikalet	4.035,48	0,00	0,00%
6	Shpenzimet tjera Operative	37.234,27	3.188,63	2,91%
7	Totali i shpenzimeve operacionale	999.010,09	109.604,22	100,00%

Tabela 5-2 Kosto operacionale e KRU Hidrodrini (Pejë, 2018), burimi : KRU Hidrodrini

Është vlerësuar që KRU Hidrodrini do t'i duheshin së paku 3 punëtorë me orar të plotë për t'u kujdesur për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit të ujërave atmosferik në për gjatësinë ekzistuese. Për nga pikëpamja operacionale, e punës ekipoje dhe shëndetit dhe sigurisë në punë, do të ishte më e përshtatshme të llogariteshin 4 persona për këtë punë. Një gjë e tillë është reflektuar në tabelën vijuese e cila përmbledh një kosto treguese vjetore për operim dhe mirëmbajtje të rrjetit ujërave atmosferik nëse një përgjegjësi e tillë i kalon KRU Hidrodrinit (për gjatësinë aktuale të rrjetit). Meqë këto aktivitete aktualisht nuk janë duke u ndërmarr, një gjë e tillë pasqyron vetëm një përlllogaritje dhe nevojë fillestare të cilat duhet verifikohen dhe përditësohen në baza vjetore. Aktivitete ndërtimore s'i p.sh: vendosja ose rregullimi i kyçjeve në rrjet nuk janë përfshirë në këtë zberthim të koston.

Përlllogaritje treguese e koston për O&M të rrjetit atmosferik			
[Qyteti i Pejës, me gjatësinë e rrjetit në 2019, në vit]		Ujerat atmosferik	
		<i>Përlllogaritja</i>	<i>Përlllogaritur në %</i>
1	Pagat, 4 Stafit operativ à 4,800 EUR p.a.	19.200,00	71,90%
2	Shpenzime riparimi & mirëmbajtje	2.000,00	7,50%
3	Rryma elektrike	4.000,00	15,00%
4	Karburanti	1.000,00	3,70%
5	Kemikalet	0,00	0,00%
6	Shpenzime tjera operative	500,00	1,90%
7	Zhvleftësimi i pajisjeve	<i>Nuk është përfshi</i>	
8	Totali i shpenzimeve operacionale	26.700,00	100,00%

Tabela 5-3 Përlllogaritje treguese e koston për O&M të rrjetit të ujërave atmosferik gjatë një viti (pa zhvleftësim)

MARRËVESHJE SHËRBIMI

PËR SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE UJËRAVE TË ZEZA

në mes të:

KOMUNËS PEJËS

dhe

KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT HIDRODRIN SH. A. - PEJË

Maj 2018

MARRËVESHJE E SHËRBIMIT

Kjo MARRËVESHJE E SHËRBIMIT ("Marrëveshje") është bërë më datë [04.05.2018] nga dhe në mes të Komunës së Pejës dhe Kompanisë Rajonale të Ujit Hidrodrini, Pejë me seli në Pejë, Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156, 30000 Pejë.

Komuna dhe KRU në tekstin e mëtutjeshëm referohen bashkarisht si "Palët" dhe ndarazi si "Pala".

PJESA HYRËSE

Në pajtim me *Ligjin për Ndërmarrjet Publike*, Republika e Kosovës është pronare e KRU-së dhe të drejtën e pronësisë mbi KRU-në e ushtron Qeveria e Kosovës (neni 5), ndërkaq me *Ligjin për Vetqeverisjen Lokale* është përcaktuar që ndër tjera kompetencat e Komunave përfshijnë edhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimit. (neni 17.1 (f)). Në anën tjetër, me *Ligjin Mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimit të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave*, është themeluar Autoriteti Rregullativ për Shërbime të Ujit ("ARRU") si autoritet i pavarur rregullator që rregullon veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit në Kosovë. Me këtë Ligj është përcaktuar që KRU-të duhet të nënshkruajnë Marrëveshje të Shërbimit me Komunitat të cilat shtrihen brenda Zonës së tyre të Shërbimit (neni 6.2. (e)).

DUKE PASUR PARASYSH SE, KRU është pronare e aseteve që shërbejnë për furnizimin me ujë dhe për ofrimin e shërbimeve të ujërave të zeza dhe rrjedhimisht përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen, përtëritjen dhe zgjerimin e këtyre aseteve

DUKE PASUR PARASYSH SE, me Ligjin për Vetqeverisje Lokale, Komuna ka përgjegjësi të ofrojë shërbimet e furnizimit me ujë të pijes dhe shërbimet e ujërave të zeza në territorin e vet

DUKE PASUR PARASYSH SE, është në interesin publik që ti jipet KRU-së e drejta ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza brenda territorit të Komunës

DUKE PASUR PARASYSH SE, Komuna dhe KRU janë marrë vesh të arrijnë objektivat vijues:

- a. Të promovojnë fuqizimin menaxherial dhe operacional të KRU-së;
- b. Të sigurojnë që KRU arrin të krijojë dhe të mbajë kapacitetet financiare në nivelin e duhur që i mundëson asaj të gjenerojë të hyra të mjaftueshme për mbulimin e plotë të kostove me qëllim që të mirëmbajë dhe operojë objektet dhe pajisjet për ofrimin e shërbimeve adekuate për popullatën e Komunës;
- c. Të promovojnë implementimin e programeve investuese efektive në aspektin e kostove me theks në përmirësimin e efijencës së sistemeve ekzistuese;

DUKE PASUR PARASYSH SE, kjo Marrëveshje ka për qëllim që të definojë të drejtat dhe obligimet e KRU-së lidhur me operimin e asetëve të sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza që i shërbejnë Komunës, dhe që të definojë të drejtat dhe obligimet e Komunës në ofrimin e ndihmës për KRU-në në arritjen e objektivave të saj

Komuna dhe KRU mirren vesh si vijon:

NENI 1 PËRKUFIZIMET

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, fjalët dhe termet në vazhdim do ta kenë kuptimin si vijon:

“Autorizimi” nënkupton të drejtën ekskluzive të cilën Komuna ia jep KRU-së për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza në territorin e Komunës;

“Data Efektive” nënkupton datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje;

“Kërkesa Ligjore” nënkupton të gjitha ligjet, aktet nënligjore, urdhëresat, licencat, lejet, dhe rregullat në fuqi të nxjerra nga institucionet kompetente që kanë juridikcion mbi çështjen në fjalë;

“Kohëzgjatja” nënkupton afatin e aplikueshmërisë së kësaj Marrëveshje;

“Komisioni Këshillues i Konsumatorëve” nënkupton komisionin e themeluar në për Zonën e Shërbimit të KRU-së në pajtim me Ligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave Ujërave të Zeza;

“Ngjarje Forcë Madhore” (“Force Majeure”) nënkupton çdo ngjarje që ndodhë përtej kontrollit të arësyeshem të KRU-së e që i shkakton asaj vonesa apo pengesa në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshje. Rastet Forcë Madhore përfshijnë: çfarëdo veprimi mbinatyror, trazira në punë, luftëra, rebelime, veprime subversive, zjarri, stuhia, tërmeti, vërshimet, ose urdhërat apo kushtëzimet e imponuara nga ushtria apo autoritetet civile të themeluara me ligj. Rastet Forcë Madhore nuk përfshijnë: mungesën e mjeteve financiare, ndryshimin e kushteve të tregut si dhe pamundësinë për të siguruar lëndët djegëse apo shërbimet për operimin e objekteve të saj, përveç nëse furnitori apo nënkontraktuesi nuk ka mundësi ti kryejë obligimet ndaj KRU-së për ndonjë arsye që do të përbënte Ngjarje Forcë Madhore.

“NJPM të NP” nënkupton Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e themeluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;

“ARRU” nënkupton **Autoriteti Rregullativ per Sherbime te Ujitë;**

“Shërbimet e Ujërave të Zeza” nënkupton grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza;

“Shërbimet e Ujësjetllësit” nënkupton marrjen, trajtimin dhe distribuimin e ujit për konsum njerëzor si dhe operimin e rrjetit dhe objekteve që përdoren për këtë qëllim;

“Standardet e Shërbimit” nënkupton secilin standard të aplikueshëm për shërbimet e ujësjetllësit dhe ujërave të zeza të përcaktuar në pajtim me Ligjin për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave;

“Tarifat e Shërbimit” nënkupton çdo ngarkesë apo tarifë e cila shfrytëzohet nga KRU për faturimin e shërbimeve të ujësjetllësit dhe ujërave të zeza;

“Zona e Shërbimit” nënkupton komunat në të cilat KRU ofron shërbimet e ujësjetllësit dhe ujërave të zeza;

NENI 2

DHËNIA E TË DREJTËS EKSKLUZIVE

2.1 Autorizimi

Komuna me këtë Marrëveshje i jep të autorizimin KRU-së sipas të cilit KRU ka të drejtën ekskluzive që gjatë afatit të kësaj Marrëveshje të ofrojë Shërbimet e Ujësjetllësit dhe Shërbimet e Ujërave të Zeza, me kusht që asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të ndalojë personat në Komunë që të kenë në pronësi dhe të operojnë me objektet të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të tyre për ujë të pijes (vet-furnizues);

2.2 Parimet udhëheqëse të kësaj Marrëveshje

Komuna dhe KRU pajtohen që aftësia për të përmirësuar kualitetin e Shërbimeve të Ujësjetllësit dhe Ujërave të Zeza varet nga:

- (a) pavarësia financiare dhe operative e KRU-së si një ndërmarrje me orientim komercial, e afërt me konsumatorët dhe financiarisht e e vet-qëndrueshme;
- (b) zbatimi i rregullave, rregulloreve, udhëzimeve dhe vendimeve të Rregullatorit dhe autoriteteve tjera që kanë kompetenca në bazë të ligjit në fusha të caktuara të veprimtarisë së KRU-së;
- (c) zhvillimi dhe mirëmbajtja e një ndjenje të fuqishme për rëndësinë e shërbimeve publike dhe orientimi në ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje;
- (d) ngritja e efikasitetit operativ të KRU-së;
- (e) ngritja e shkallës së arkëtimit të faturave;

- (f) marrja e vendimeve kost-efektive për investimet e nevojshme në sistemet e ujësjellësit dhe ujëra të zeza me qëllim të ruajtjes së bazës ekzistuese të aseteve dhe zgjerimit të tyre;
- (g) Puna e përbashkët dhe bashkëpunimi i Palëve për arritjen e objektivave të tyre.

2.3 Rregullimi i Shërbimeve të Ujësjetllësit dhe Ujëra të Zeza

Palët kanë parasysh se rregullimi i veprimtarisë së KRU-së i nënshtrohet *Ligjit për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetllësit, Kanalizimit për zbatimin e të cilit është përgjegjës Autoriteti Rregullativë, ndërkaq çështjet që kanë të bëjnë me pronësinë, qeverisjen korporative, llogaridhënien dhe raportimin i nënshtrohen *Ligjit për Ndërmarrjet Publike*. Çfarëdo konflikti ndërmjet kësaj Marrëveshje dhe këtyre dy ligjeve do të zgjidhet në favor të këtyre ligjeve si dhe ligjeve tjera të aplikueshme në Kosovë.*

2.4 Obligimet e Shërbimit

Dhënia nga Komuna e të drejtës ekskluzive KRU-së nënkupton që KRU të operojë në pajtim me kornizën rregullatore në fuqi si dhe në pajtim me ligjet e aplikueshme, duke pasur parasysh si vijon:

- (a) KRU duhet të operojë me objektet dhe pajisjet e saj që i shfrytëzon për ofrimin e shërbimeve në pajtim me praktikën e mira për shërbimet publike. KRU duhet të ofrojë shërbime të sigurt, të cilësisë së duhur dhe jo-diskriminuese në asnjë aspekt, dhe poashtu të bëjë përmirësimet, zgjerimet dhe ngritjen e kapaciteteve në përputhje me rritjen e konsumatorëve sipas nevojës;
- (b) Në rast të ndonjë Ngjarje Forcë Madhore, KRU duhet të bëjë përpjekje të duhura që të krijojë mundësi për ofrimin e shërbimeve të sigurt dhe të vazhdueshme për të gjithë konsumatorët konfrom situatës së krijuar;

2.5 Obligimet e KRU-së

- (a) të ofrojë shërbimet sipas kësaj Marrëveshje në mënyrë efektive dhe efiziente në pajtim me Standardet Minimale të Shërbimit;
- (b) të përcaktojë dhe zbatojë politika dhe procedura operative për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje, duke përfshirë politikat dhe procedurat për veprim në situatë emergjente, zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve si dhe çështjet e personelit;
- (c) të hartojë programin e investimeve kapitale duke konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e Komunës;

- (d) të propozojë tarifat e shërbimit për aprovim nga Rregullatori në pajtim me rregullat dhe metodologjinë e aplikueshme bazuar në parimin e mbulimit të kostove operative dhe të investimeve kapitale të nevojshme për ofrimin e shërbimeve në pajtim me standardet e shërbimit në fuqi;
- (e) të ndërmarrë të gjitha masat e duhura, duke përfshirë edhe ndërprerjen e shërbimeve ndaj konsumatorëve, kur një gjë e tillë është e nevojshme për arkëtimin e borxheve nga konsumatorët;
- (f) të raportojë rregullisht te NJPM e NP dhe ARRU për çështjet financiare, operative dhe të cilësisë së shërbimeve në pajtim me obligimet e përcaktuara në bazë të ligjit, dhe këto raporte ti vihen në dispozicion Komunës dhe të bëhen publike për konsumatorët;
- (h) të informojë Komunën mbi aktivitetet e KRU-së në formën dhe shpeshtësinë siç mirren vesh Palët;
- (i) të ndërmerrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura në pajtim me ligjet e aplikueshme që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj Marrëveshje;

Obligimet e KRU-së sipas kësaj Marrëveshje përmbushen me kusht që:

- (k) Komuna i përmbush obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshje, dhe
- (l) asnjë ligj, rregullore nacionale apo lokale, dekret apo resolutë nuk miratohet që do të bënte ligjërish të pamundur përmbushjen e obligimeve sipas kësaj Marrëveshje.

2.6 Obligimet e Komunës

- (a) ti paguajë me kohë faturat e KRU-së për shërbimet që i ofrohen Komunës apo institucioneve tjera që financohen prej buxhetit të saj;
- (b) ti lejojë KRU-së ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efizente pa u penguar nga Administrata Komunale;
- (c) ti ofrojë me kohë KRU-së informata relevante për planifikimin, zhvillimin dhe zgjerimin e Komunës në mënyrë që KRU ti shqyrtojë ato informata dhe ti përfshijë në planet e saj të investimeve kapitale dhe operative;
- (d) të informojë dhe të bashkëpunojë ngushtë me KRU-it në të gjitha fazat e investimeve që i bën Komuna në sistemin e ujësjellësit dhe ujëra të zeza në territorin e vet duke përfshirë: planifikimin, projektimin, mbikqyrjen dhe pranimin teknik të objekteve dhe rrjetit që shërben për shërbimet e ujësjellësit dhe ujëra të zeza

- (e) ti shqyrtojë dhe komentojë programet e investimeve kapitale të KRU-së në mënyrë që të arrihet koordinim me objektivat planifikuese të Komunës;
- (f) ti ndihmojë dhe ta mbështesë KRU-në me të gjitha mjetet e duhura në ndërmarrjen e të gjitha masave për arkëtimin e faturave nga konsumatorët për shërbimet e ofruara në pajtim me dispozitat e ligjeve të aplikueshme;
- (h) të bashkëpunojë me KRU-në në të gjitha format e nevojshme dhe adekuate për ti mundësuar KRU-së përmbushjen e obligimeve të saj sipas kësaj Marrëveshje;
- (i) të propozojë anëtarët për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve të cilët themelohen dhe funksionojnë në regjionin e Zonës së Shërbimit të KRU-së në pajtim me ligjin e aplikueshëm;
- (j) të ndërmarrë të gjitha vendimet dhe veprimet e duhura në pajtim me ligjet e aplikueshme që janë të nevojshme për përmbushjen e obligimeve të kësaj Marrëveshje;

Obligimet e Komunës sipas kësaj Marrëveshje përmbushen me kusht që:

- (k) KRU i përmbush obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshje, dhe
- (l) asnjë ligj, rregullore nacionale apo lokale, dekret apo resolute nuk miratohet që do të bënte ligjërish të pamundur përmbushjen e obligimeve sipas kësaj Marrëveshje.

NENI 3 LEHTËSIMET

3.1 E Drejta e Shfrytëzimit të Pronës Publike

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje dhe gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje, KRU-së i jipet e drejta e shfrytëzimit të hapsirës mbi, nën, përgjatë ose në objekte publike, ura dhe pronë tjetër publike duke përfshirë rrugët, trotualet, autostradat dhe hapësirat e gjelbëruara me qëllim të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së tubacioneve nëntokësore, pusetave dhe objektet tjera të ngjajshme që mund të jetë e nevojshme dhe e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Marrëveshje (që referohet si e “ E Drejta e Shfrytëzimit të Pronës Publike”).

3.2 Shfrytëzimi i të Drejtës në Pronën Publike

